



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26 regjistër (JR)  
Datë 17.05.2021

Nr. 17 i vendimit  
Datë 27.05.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.05.2022, në orën 13:00, ditën e premte, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 26/2021, datë 17.05.2021, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni) (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Fillimisht, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

1. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
2. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
4. Nuk ka kryer deklarim të rremë.
5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka

---

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2018.

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit nr. {\*\*\*}, datë 27.10.2020), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni).

**2.3 KLGj-ja** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raportin e hollësishëm e të arsyetuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.11.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni).

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale), dhe, në përfundim, mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 344, datë 11.02.2021.

## **II. Në lidhje me vendimin e Komisionit**

4. Komisioni, me vendimin nr. 344, datë 11.02.2021, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), e cila në momentin e vendimmarrjes ushtronte funksionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

**5.1. Për vlerësimin e pasurisë:** Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe provat e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

**5.2. Për kontrollin e figurës:** Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

**5.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale:** Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, neneve 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSh”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGj-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: *Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Në lidhje me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

6. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c<sup>2</sup>” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, *Rekomandimin për paraqitje ankimi* me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.04.2021, ndaj vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni). Objekti i këtij rekomandimi sjell në vëmendje se vendimet e Kolegjit vendosin standarde për interpretimin e dispozitave ligjore të ligjit nr. 84/2016, duke siguruar kështu udhëzime për organet e rivlerësimit në raste të ngjashme, duke u shprehur se: [...] *Gjetjet në rastin e G. dhe Marinela Osmanit nuk janë vetëm të ngjashme, por “de facto” identike, gjë që nxjerr në pah (të paktën prima facie) mospërputhjen e standardeve të përdorura nga Komisioni në vendimin që konfirmon Marinela Osmanin, kundrejt atyre të zbatuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin 20/2019 (dhe në vendimet e mëparshme), pa dhënë një arsyetim të kënaqshëm për këtë dallim [...].* Për sa më sipër, ONM-ja i ka rekomanduar Komisionerit Publik të ushtrojë ankim mbi vendimin nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të znj. Marinela Osmani (Nuni).
7. Komisioneri Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 344, datë 11.02.2021, për subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar kontrollin e këtij vendimi nga Kolegji. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**7.1** Komisioneri Publik fillimisht sjell në vëmendje të Kolegjit se, me vendimin e tij (JR) nr. 20/2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 61/2018 të Komisionit, duke shkarkuar nga detyra

---

<sup>2</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

subjektin e rivlerësimit G. O. (i cili njëkohësisht është bashkëshorti dhe personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani), pas konstatimit të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nisur nga rrethanat specifike të rastit, kur të dy bashkëshortët ishin njëkohësisht subjekte rivlerësimi, në vendimin e Kolegjit nr. 20/2019, për sa i takon zhvillimit të procesit të rivlerësimit për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit në atë gjykim (subjektit të rivlerësimit në këtë çështje konkrete, znj. Marinela Osmani), për të përjashtuar ndikimin e vendimmarrjes për z. G. O. në procesin e saj argumentohet se: [...] *trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe sqaron se ky vendim në asnjë mënyrë nuk paragjykon të drejtën e saj për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk do të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, të cilin bashkëshortja e subjektit ka të drejtë ta ketë, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së saj dhe në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.*

**7.1.1** Në vijim, Komisioneri Publik sjell në vëmendje konkluzionet e Komisionit në vendimin objekt ankimi për vlerësimin e pasurisë në tërësi për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni): *Në përfundim të analizës, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen cash, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues rendit disa rrethana faktike lidhur me ndikimin që merr kjo balancë negative ndaj subjektit të rivlerësimit në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje:*

- i. ajo është e njëjtë me atë për të cilën edhe u aplikua masa disiplinore ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me vendimin përfundimtar të KPA-së;*
- ii. pasuria, në vlerësimin e provave dhe bindjen e brendshme, rezultoi e deklaruar me saktësi dhe e krijuar me burime të ligjshme;*
- iii. nga hetimi tërësor nuk u konstatuan të dhëna lidhur me pasuri të fshehura, deklarime të rreme apo ndonjë problematikë tjetër sa i përket këtij kriteri;*
- iv. për sa më sipër, rrethanat e mbetura nga kriteri i pasurisë janë vlerësuar në harmoni edhe me procesin e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, për të cilat nuk rezultoi ndonjë problematikë;*
- v. aplikimi i së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, në vështrim të konstatimeve të renditura më sipër, nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**7.1.2** Komisioneri Publik konstatoi se, lidhur me këtë situatë faktike të referuar sa më lart për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), për efekt të procesit të rivlerësimit të z. G. O., në referencë të vendimit nr. 20/2019 të Kolegjit, është argumentuar se: [...] *sa i përket shkakut që lidhet me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurisë likuiditet, në formën e gjendjes cash, dhe të shpenzimeve për jetesë e shlyerjen e detyrimit ndaj personit tjetër të lidhur, në vitet 2011 e 2013, mungesë e cila e çon Kolegjin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit G. O. nuk*

*ka justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në pronësi të tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

**7.2** Komisioneri Publik ka pretenduar se Komisioni, në vendimin e tij, duket se mjaftohet me një konstatim që balanca negative në shumën 1.785.365 lekë, në raport me rrethanat faktike dhe vlerësimin tërësor të çështjes, nuk çon në aplikimin e së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, pasi nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**7.3** Komisioneri Publik parashtron se, referuar përmbajtjes së nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është prerogativë e Komisionit, ashtu sikurse dhe e Kolegjit, që vendimmarrjen, edhe në procesin e rivlerësimit të znj. Marinela Osmani (Nuni), ta mbështesë në zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Vetë Kolegji e ka drejtuar vëmendjen e Komisionit në zbatimin e këtyre parimeve, në vendimin (JR) nr. 20/2019.

**7.4** Komisioneri Publik pretendon se në vlerësim të përmbajtjes së pikës 4 të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, në vendimin konkret të Komisionit objekt ankimi, për efekt të rivlerësimit të pasurisë në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, vetëm citohen rrethanat e çështjes, por ato nuk shoqërohen me përfundimet që ka nxjerrë Komisioni nga vlerësimi i këtyre rrethanave, duke iu referuar zbatimit të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.

**7.5** Sa më sipër, Komisioneri Publik argumenton se në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, çmon si të nevojshme që kjo çështje të paraqitet për shqyrtim në Kolegj dhe, nëse eventualisht zgjidhja e saj do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit, z. G. O., të jepet arsyetimi i duhur nga Kolegji, duke siguruar parime udhëzuese për raste të ngjashme për subjektet e rivlerësimit, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësimi.

**8.** Fillimisht, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, Kolegji të vendosë:

*- Lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;*  
ose:

*- Ndryshimin e këtij vendimi.*

**8.1** Në bisedimet përfundimtare të çështjes, pas përfundimit të hetimit gjyqësor, Komisioneri Publik, në kuadër të ankimit, i kërkoi Kolegjit të vlerësojë mundësinë që, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, t'i rekomandojë Komisionit, në formën e një orientimi, duke dhënë *parime udhëzuese* për raste të ngjashme për subjekte rivlerësimi, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësimi, për sa i përket zbatimit të *parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit*. Në funksion të parimeve udhëzuese, të cilat duhet të zbatohen në raste të ngjashme, Komisioneri Publik vlerëson se zbatimi i parimit të objektivitetit dhe i parimit të proporcionalitetit, në vlerësimin e kriterit pasuror, duhet të verifikohen rast pas rasti, bazuar në evidentimin e rrethanave

objektive që dalin nga aktet e administruara në fashikujt e procedurës së rivlerësimit të bashkëshortëve dhe, pasi këto rrethana vendosen përballë përfundimeve të arritura mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të krijimit të pasurisë, të vlerësohet nëse gjen vend zbatimi i parimit të proporcionalitetit.

*Lidhur me zbatimin e parimit të objektivitetit*, sipas Komisionerit Publik, eventualisht, Komisioni, bazuar në orientimin e kërkuar prej Kolegjit, do të duhet të marrë në konsideratë të gjitha kushtet, të dhënat dhe provat që dalin nga procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, për të cilin procesi i rivlerësimit ka përfunduar me vendim dhe, ndër të tjera, të evidentojë:

- i. përputhshmërinë e deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “vetting”, si dhe gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni (evidentimin nëse këto deklaratat janë në harmoni apo në kontradiksion me njëra-tjetrën);
- ii. nëse pamjaftueshmëria financiare e konstatuar është e njëjtë për të dyja subjektet dhe vjen si rezultat i shpenzimeve, investimeve dhe kursimeve të përbashkëta;
- iii. nëse pamjaftueshmëria financiare e konstatuar lidhet me një moment specifik të krijimit të një pasurie konkrete, si dhe/ose me shtrirjen në kohë;
- iv. llojin dhe vlerën e pasurive të disponuara nga subjekti dhe personi i lidhur, të krijuara me burime financiare të përbashkëta;
- v. nëse konstatohet fshehje e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur me të;
- vi. nëse konstatohet të jetë kryer deklarim i rremë nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur me të.

*Lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit*, Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa standarde objektive të vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, të cilat zbatohen rast pas rasti, si: (i) masa disiplinore e shkarkimit të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit; (ii) gjykimi duhet bërë në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit dhe që rëndësia e shkeljes të jetë e tillë që të lejojë ose jo zbatimin e këtij parimi; (iii) dhënia e një mase disiplinore, e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

**8.2** Duke mbajtur qëndrimin përfundimtar për çështjen objekt gjykimi, Komisioneri Publik vlerësoi se, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit, përkundrejt *parimeve udhëzuese* të propozuara për t’u trajtuar sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), gjendet në këto rrethana objektive: (i) deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur me të janë në harmoni dhe nuk kanë kontradikta ndërmjet tyre; (ii) pamjaftueshmëria financiare e konstatuar është e njëjtë për të dyja subjektet dhe vjen si rezultat i shpenzimeve dhe i deklaratimit të kursimeve të përbashkëta, pamjaftueshmëri për të cilën është aplikuar masa disiplinore e shkarkimit për personin e lidhur/bashkëshorti sipas vendimit (JR) nr. 20/2019; (iii) pamjaftueshmëria financiare e konstatuar është e shtrirë në kohë dhe nuk lidhet me një moment specifik të krijimit të ndonjë pasurie; (iv) me kursimet e deklaruara ndër vite dhe huan, subjekti i

rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë krijuar një pasuri të paluajjtshme; (v) nuk është konstatuar deklarim i rremë, fshehje pasurie apo gjendja në kushtet e konfliktit të interesit nga subjekti i rivlerësimit.

**8.3** Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në rastin konkret, parë nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe vlerësimit tërësor të procedurës së rivlerësimit, ku nuk janë konstatuar problematika në kontrollin e kriterit të figurës dhe kriterit të aftësive profesionale, çon në përfundimin se rëndesa e kësaj shkeljeje, për të cilën është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për personin e lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është e tillë që lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

**8.4** Përfundimisht, Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit që, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave të administruara dhe të rikonfirmuara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje, të vendosë lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), duke arsyetuar (Kolegji) në vendim edhe orientimin që duhet të ketë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mbi zbatimin e *parimeve udhëzuese* për raste të ngjashme, për subjektet e rivlerësimit të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësimi.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016. Meqenëse çështja e subjektit të rivlerësimit ka të bëjë me një ankim të Komisionerit Publik, të mbështetur në një rekomandim të ONM-së, mbi bazën e nenit 20, pika 1, paragrafi i dytë, *i ndryshuar*, i rregullores për veprimtarinë e Kolegjit, çështja e subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), u shqyrtua me përparësi.

###### *ii. Legjitimitimi i ankuesit*

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016



dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65<sup>3</sup>, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 344, datë 11.02.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit.

*B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik, si dhe me parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.*

12. Në seancën gjyqësore publike të datës 21.04.2022, Komisioneri Publik, në parashtrimet e paraqitura në Kolegji, theksoi se, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara. Komisioneri Publik parashtrroi se, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës, është institucioni i rivlerësimit, të cilit Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i drejton rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit, si dhe u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, dhe kërkoi që shkaqet e parashtruara në ankim, të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit.
13. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegji në seancën e datës 21.04.2022, në përfundim, duke u bazuar në tërësinë e çështjes, si dhe të procedurave të zhvilluara si ndaj bashkëshortit, edhe ndaj saj, kërkoi nga Kolegji një vlerësim të drejtë dhe tërësor sipas orientimeve të dhëna nga Kolegji në vendimin e tij nr. 20/2019 (JR), në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe të standardeve të evoluara, të aplikuara në praktikën gjyqësore/jurisprudencën e organeve të rivlerësimit kalimtar. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien ne fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

---

<sup>3</sup> *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

14. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të mbrohet dhe të japë shpjegime në lidhje me to. Kolegji vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegji nga Komisioni dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike. Bazuar në situatën faktike të konstatuar dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit*

15. Lidhur me kërkimin e Komisionerit Publik që, në kuadër të shqyrtimit të ankimit, Kolegji fillimisht të japë orientime të përgjithshme për Komisionin mbi zbatimin e parimeve udhëzuese që lidhen me objektivitetin dhe proporcionalitetin për raste të ngjashme, për subjektet e rivlerësimit, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësi dhe, mbi bazën e këtyre orientimeve, të vlerësojë bazueshmërinë dhe drejtësinë e vendimit objekt kontrolli, duke e lënë atë në fuqi, Kolegji vlerëson se për situatat hipotetike që mund të rezultojnë në të ardhmen në çështje të tjera ku subjekte të rivlerësimit janë magjistratë bashkëshortë, të paraqitura nga Komisioneri Publik në argumentimin e kërimit të tij, por që nuk janë situata të lidhura drejtpërdrejt me situatën specifike faktike dhe ligjore të vendimit objekt shqyrtimi, marrja në shqyrtim e një kërkimi të tillë tejkalon të drejtat dhe detyrat e Kolegjit të përcaktuara në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi Kolegji nuk mund t'i japë Komisionit orientime *in abstractia* (që nuk lidhen me çështje konkrete). Si rrjedhojë, Kolegji, kontrollin e vendimit objekt shqyrtimi, e bën vetëm mbi zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit për situatën faktike dhe ligjore të çështjes konkrete, duke mbajtur në konsideratë edhe vlerësimin që Komisioneri Publik u bëri këtyre parimeve në argumentimin e kërimit të tij përfundimtar para Kolegjit.
16. Komisioneri Publik pretendoi në ankim se vendimi nr. 344, datë 11.02.2021, i Komisionit ka nevojë t'i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, me qëllim që të vlerësohet praktika ekzistuese dhe, nëpërmjet vendimit të tij, Kolegji të mundet eventualisht të orientojë Komisionin në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, në rastet kur subjekti i rivlerësimit konkret dhe bashkëshortja/bashkëshorti i tij (person i lidhur) janë njëkohësisht subjekte të rivlerësimit në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës. Komisioneri Publik vlerëson se me gjithë argumentin e dhënë nga Kolegji në vendimin e tij (JR) nr. 20/2019, që i përket G. O., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), nuk rezulton që nëpërmjet interpretimit të jetë dhënë orientim në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, në kuptim të pikës 2 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, Komisioneri Publik çmoi si të nevojshme që kjo çështje të paraqitet për shqyrtim në Kolegji dhe, nëse eventualisht zgjidhja e kësaj çështjeje do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit, z. G. O., nga Kolegji të jepet arsyetimi i nevojshëm/i duhur, duke siguruar parime udhëzuese për raste të ngjashme për subjektet e rivlerësimit, të cilët janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësi.

**16.1 Konkuzionet e Komisionit** për vlerësimin e pasurisë në tërësi për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni): *Në përfundim të analizës, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen cash, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues rendit disa rrethana faktike lidhur me ndikimin që merr kjo balancë negative ndaj subjektit të rivlerësimit në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje:*

- i. ajo është e njëjtë me atë për të cilën edhe u aplikua masa disiplinore ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me vendimin përfundimtar të KPA-së;*
- ii. pasuria, në vlerësimin e provave dhe bindjen e brendshme, rezultoi e deklaruar me saktësi dhe e krijuar me burime të ligjshme;*
- iii. nga hetimi tërësor nuk u konstatuan të dhëna lidhur me pasuri të fshehura, deklarime të rreme apo ndonjë problematikë tjetër sa i përket këtij kriteri;*
- iv. për sa më sipër, rrethanat e mbetura nga kriteri i pasurisë janë vlerësuar në harmoni edhe me procesin e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, për të cilat nuk rezultoi ndonjë problematikë;*
- v. aplikimi i së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, në vështrim të konstatimeve të renditura më sipër, nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**16.2 Komisioneri Publik**, në ankimin e paraqitur në Kolegj kundër vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), nuk ka identifikuar shkaqe lidhur me kriteret e vlerësimit, përveçse ka konstatuar diferencën negative të nxjerrë nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit në vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë. Komisioneri Publik, në kuptim të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka argumentuar se është prerogativë e Komisionit dhe e Kolegjit që procesin e rivlerësimit të znj. Marinela Osmani (Nuni) ta mbështesë në zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Vetë Kolegji e ka drejtuar vëmendjen e Komisionit në zbatimin e këtyre parimeve në vendimin (JR) nr. 20/2019. Duke qenë se Komisioneri Publik në këtë ankim ka kërkuar orientim nga Kolegji nëse eventualisht zgjidhja e kësaj çështjeje do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit G. O., si do të veprohet në raste të ngjashme kur dy subjekte rivlerësimi janë bashkëshortë, u krye një analizë financiare e përgjithshme për të vlerësuar se në çfarë kushtesh, në raport me mundësitë financiare, ndodhet subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), krahasimisht me bashkëshortin e saj, z. G. O.

*Pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit*

**16.3 Apartament banimi**, deklaruar në deklaratën *vetting*, me sipërfaqe banimi 96 m<sup>2</sup> dhe 12 m<sup>2</sup> ambiente të përbashkëta, blerë me kontratën e shtiblerjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2017, ndërmjet shitësit shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe blerësve G. dhe Marinela Osmani (Nuni), ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi llogarinë

bankare në Bankën Credins, e krijuar me të ardhurat nga shitja e apartamentit 72 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, dhe nga shuma 2.000 euro, të ardhura nga kursimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), dhe të personit të lidhur.

#### *Pasuritë e luajtshme*

**16.4** *Automjet me targë {\*\*\*}*, i markës “Volkswagen”, blerë në çmimin 400.000 lekë, fituar me kontratën e shitblerjes së datës 07.07.2015, me nr. {\*\*\*} dhe rep., {\*\*\*} kol., me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur.

**16.5** *Kursime cash, në shumën 400.000 lekë*, jashtë sistemit bankar, deklaruar në deklaratën *vetting*, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur.

**16.6** *Llogari bankare pranë Bankës Credins, në shumën 20.060 euro*, deklaruar në deklaratën *vetting*, me pjesë takuese 1/2, me burim krijimi kursime të subjektit, znj. Osmani, dhe të personit të lidhur.

**17.** Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar si më poshtë vijon.

**17.1** Në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2011, kanë deklaruar: (i) kursime *cash* në shumën 500.000 lekë, me burim krijimi kursime nga të ardhurat e punës së subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur; (ii) shlyerje të huas kundrejt personit tjetër të lidhur, z. A. Q., në shumën 7.000 euro.

**17.2** Në DIPP-në e vitit 2013, kanë deklaruar: (i) kursime *cash* në shumën 1.450.000 lekë, me burim krijimi kursime nga të ardhurat e punës së subjektit, znj. Osmani, dhe personit të lidhur; (ii) shlyerje të huas kundrejt personit tjetër të lidhur, z. A. Q., në shumën 8.000 euro.

**17.3** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), nuk ka pasur mundësi financiare gjatë viteve 2011 dhe 2013, për të shlyer huan, të shtojë kursimet vit pas viti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare për diferencën negative në shumën 1.785.365 lekë.

**17.4** Komisioneri Publik argumenton në ankim se Komisioni, në vendimin e tij, mjaftohet me një konstatim se balanca negative në shumën 1.785.365 lekë, në raport me rrethanat faktike dhe vlerësimin tërësor të çështjes, nuk çon në aplikimin e së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, pasi nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**17.5** Komisioneri Publik në ankimin e ngritur kundër vendimit të Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk ka ngritur shkaqe ankimi lidhur me pasuritë në veçanti,

përveçse ka vlerësuar diferencën negative të nxjerrë nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit në vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë. Duke qenë se Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit, ka kërkuar orientim nga Kolegji nëse eventualisht zgjidhja e kësaj çështjeje do të jetë e ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit G. O., si do të veprohet në raste të ngjashme kur dy subjekte rivlerësi janë bashkëshortë, në Kolegj u krye një analizë financiare për periudhën 2009 - 2013, nga momenti i investimit (2009) në pasurinë apartament banimi me sip. 72 m<sup>2</sup> deri te shlyerja e huas së marrë për blerjen e këtij apartamenti (2013), me qëllim identifikimin e situatës financiare në të cilën ndodhej subjekti i rivlerësimit në këtë periudhë, krahasimisht me çfarë ka rezultuar për bashkëshortin e saj, z. G. O.

**17.6 Pasuria “apartament banimi”, me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2009 prej subjektit të rivlerësimit, nuk gjendet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë pronë në vitin 2016 dhe paratë e përfituara nga ky veprim juridik kanë shërbyer si një prej burimeve për blerjen e apartamentit në të cilin banon sot dhe i cili është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si apartament<sup>4</sup> me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri (apartament me sip. 72 m<sup>2</sup>) ka qenë objekt verifikimi e kontrolli në kuptim të procesit të rivlerësimit, pikërisht për shkak se ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament që është sot në pronësi të subjektit të rivlerësimit.**

**17.7 Konkluzionet dhe arsyetimi i Komisionit lidhur me analizën financiare për periudhën 2009-2013:** Komisioni lidhur me qëndrimin e subjektit për gjendjen *cash*, arsyeton duke mbajtur në konsideratë deklaratimet periodike vjetore të subjektit, deklaratimet gjatë hetimit administrativ, pretendimet e subjektit në prapësime, si dhe qëndrimin e Kolegjit për aq sa orientohet në të. Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me deklaratimet e kryera gjatë viteve 2009 – 2011. Për këtë periudhë, në deklaratimet e kursimeve në gjendjen *cash*, është përfshirë edhe gjendja likuiditet në banka në fund të çdo viti, deri në vitin 2011, duke qenë se nga analizimi dhe krahasimi i këtyre deklaratimeve, në të gjitha vitet, nuk u konstatua asnjë rast i vetëm në të cilin gjendja likuiditet në bankë të tejkalonte gjendjen e deklaruar si *cash*. Ndërsa, për vitet pas kësaj periudhe, Komisioni u ka qëndruar me përpikëri deklaratimeve periodike të subjektit, ku shumat e deklaruara janë konsideruar si shtesa, për sa kohë nuk është përcaktuar ndonjë destinacion i përdorimit të gjendjes *cash* apo në funksion të shlyerjes së ndonjë detyrimi. Ndërsa, aty ku subjekti ka përcaktuar destinacionin e shpenzimit, shuma është zbritur nga gjendja *cash*, duke rezultuar: *[...] Në përfundim të analizës, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen cash, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

---

<sup>4</sup> Apartament banimi me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> dhe 12 m<sup>2</sup> ambiente të përbashkëta, blerë me kontratën e shtiblerjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2017.

17.8 Në vendimin e Kolegjit nr. 20/2019, datë 31.07.2019, për subjektin e rivlerësimit G. O. është konkluduar: *Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit për vitin 2011 nuk kishte burime të mjaftueshme financiare për të përballuar shpenzimet e krijimit e kursimeve të tij, në shumën 586.542 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 1.173.955 lekë. Ndërsa, referuar situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2012, nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit mbulon shpenzimet me të ardhura të ligjshme. Rezultatet e kësaj analize financiare ishin përgjithësisht të njëjta dhe të mbështetura në të njëjtën logjikë me atë të kryer në Komision [...].*

17.9 Në deklaratën *vetting*, kjo pasuri (apartamenti me sip. 65 m<sup>2</sup> + 7 m<sup>2</sup>) është deklaruar si burim që ka shërbyer për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 96 m<sup>2</sup>, blerë më datë 13.01.2017. Përshkrimi në deklaratën *vetting*, është: *Shitja e pasurisë nr. {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, adresa: rruga “{\*\*\*}”, hyrja {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, lloji apartament 1+1, me sipërfaqe prej 72 metrash katrorë, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.12.2016, në vlerën 80.000 euro (fituar me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2016, porositur me aktmarrëveshjen nr. {\*\*\*} rep., datë 02.02.2009, me vlerë 67.680 euro, nga e cila është paguar vetëm 63.680 euro).*

17.10 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *apartament banimi me sip. 72 m<sup>2</sup>, porositur me aktmarrëveshjen nr. {\*\*\*} rep., datë 02.02.2009, në shumën 67.680 euro, nga të cilat, për vitin 2009, paguar 47.680 euro, për shkak të shtyrjes së punimeve. Burime të pagesës deri në 31.12.2009, janë: 1. Të gjitha kursimet cash në vite (së bashku me bashkëshortin). 2. Një pjesë e huas në shumën 20.000 euro. 3. Të gjitha të ardhurat nga dhurimi në shumën 1.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

17.11 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: *Lidhja e kontratës përfundimtare të blerjes së pasurisë nr. {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, adresa: rruga “{\*\*\*}”, hyrja {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, e llojit apartament 1+1, me sipërfaqe prej 72 metrash katrorë, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2016, porositur me aktmarrëveshjen nr. {\*\*\*} rep., datë 02.02.2009, me vlerë 67.680 euro, nga e cila është paguar vetëm 63.680 euro. Diferenca prej 4.000 eurosh është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonesë të apartamentit.*

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision një deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.10.2016, të administratores së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, A. D., sipas së cilës, meqenëse sipas aktmarrëveshjes së datës 02.02.2009, të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. G. O., apartamenti i porositur prej tij, me 65 m<sup>2</sup>, nuk i është dorëzuar në datën 31.05.2010, por në datën 31.05.2011, si rrjedhojë, sipas nenit 9 të aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërisë ndërtuese dhe z. G. O., iu zbritën 4000 euro penalitet. Si rrjedhojë, sipas kësaj deklarate, z. G. O. ka paguar gjithsej shumën 63.680 euro.

Ky apartament me sipërfaqe prej 72 m<sup>2</sup>, është shitur me kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.12.2016, në vlerën 80.000 euro.

**17.12** Për blerjen e apartamentit 72 m<sup>2</sup>, rezultojnë si burime: (1) të gjitha kursimet *cash* në vite (së bashku me bashkëshortin); (2) huaja në shumën 20.000 euro; (3) dhurimi i prindërve në shumën 1.500.000 lekë. Lidhur me dhurimin nga prindërit, në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse ka pasur ndonjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro, në përgjigje të së cilës subjekti ka sqaruar se: *Përveç sa është shpjeguar në pyetjet e tjera, deklaroj se nga ana e prindërve të mi, më është bërë një dhurim në muajin janar 2009, për shkak të porositjes së një apartamenti banimi, për shkak të kontributit të dhënë nga ana ime në familje në vitet 2002 - 2008 dhe për shkak të 30-vjetorit të ditëlindjes sime (02.02.1979), në shumën prej 1.500.000 lekësh. Kjo shumë ka shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit të porositur me aktmarrëveshjen, datë 02.02.2009. Për shkak të marrëdhënieve të posaçme, nuk kam lidhur ndonjë kontratë dhurimi. Lekët më janë dhënë dorazi, për shkak të marrëdhënieve të posaçme.*

**17.13** Në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, është pyetur nga Komisioni për mënyrën e pagesës së këtij apartamenti, e cila, në përgjigje të kësaj pyetjeje, ka sqaruar: “1. Në datë 31.01.2009, nga ana e bashkëshortit, është bërë pagesa e shumës prej 15.000 eurosh dhe, më pas, në datë 02.02.2009, është lidhur kontrata me shkrim.

2. Me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2009, nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, na është lejuar të paguajmë deri në fund të vitit 2009, një shumë prej 32.680 eurosh, nga 40.000 euro të parashikuar në kontratë. Pra, si rrjedhojë, në muajin mars është lëshuar, për provueshmëri dhe për lehtësi të pagesës në vijim të kështit të dytë, mandati nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2009 (i cili, sipas kontratës, përmblihte dy këste). Në fillim është paguar shuma që ne kishim në euro, deri në atë moment, pra shuma 20.149 euro (nga kursimet në vitet paraardhëse dhe dhurimi).

3. Në fund të korrikut të vitit 2009, është paguar një shumë tjetër prej 5.000 eurosh nga kursimet gjatë këtij viti, që përkojnë me një pjesë të kursimeve të këtij viti në vlerën 5.000 euro, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të muajit korrik 2009 – 129.656 lekë, është në shumën 648.280 lekë.

4. Në datë 21.08.2009, me formalizimin e kontratës së huas me shkrim në datë 21.08.2009, është marrë nga z. A. Q., vlera prej 20.000 eurosh.

5. Në muajin shtator, është paguar dhe një shumë prej 5.000 eurosh nga huaja.

6. Nga fund viti, dhjetor 2009, është paguar totalisht shuma e mbetur, e përcaktuar në mandatin e arkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2009, që duhet të ketë qenë në vlerën rreth 2.531 euro [...]”.

**17.14** Trupi gjykues vëren se në dokumentacionin e administruar në Kolegj, Komisioni i ka kërkuar informacion të detajuar shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.11.2020, për mënyrën e shlyerjes së pagesës së çmimit të këtij apartamenti, nëse këto pagesa janë kryer me transaksione bankare apo në arkë kundrejt lëshimit të mandatpagesës, si dhe nëse janë shlyer të gjitha kështet e pasurisë.

Në përgjigjen<sup>5</sup> që ka sjellë, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK shpjegon se, bazuar në aktmarrëveshjen e datës 02.02.2009, të lidhur me z. G. O. për ndërtimin e një apartamenti banimi, e ndjekur nga kontrata e

---

<sup>5</sup> Përgjigje e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, datë 04.12.2020.

shitjes e datës 17.09.2016, çmimi i këtij apartamenti ka qenë 67.680 euro dhe se subjekti i rivlerësimit ka shlyer apartamentin sipas 6 mandatpagesave<sup>6</sup>, të paraqitura nga shoqëria ndërtuese. Në këtë shkresë, gjithashtu sqarohet se janë paguar gjithsej vetëm 63.680 euro, ndërkohë që nuk janë paguar 4.000 euro nga z. G. O., si penalitet ndaj shoqërisë ndërtuese, për shkak të vonesës së përfundimit të punimeve. Referuar mandatpagesave të përcjella prej kësaj shoqërie, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, dhe bashkëshorti i saj kanë shlyer çmimin për blerjen e apartamentit, në total prej 63.680 eurosh.

**17.15** Kolegji vëren se nga të dhënat e mësipërme, rezulton që përgjigja e subjektit të rivlerësimit ndryshon me informacionin e shoqërisë vetëm për mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2009, në shumën 32.680 euro. Vlen për t'u sqaruar se në përgjigjen e dërguar në Komision nga shoqëria e ndërtimit, pikërisht në citimin e mandatit nr. {\*\*\*}, ka vënë dhe periudhën 21.03.2009 - 31.12.2009, duke nënkuptuar se shuma prej 32.680 eurosh sipas këtij mandati, është shlyer e shtrirë në kohë përgjatë vitit 2009. Për mënyrën e shlyerjes së çmimit të apartamentit sipas kësteve të aktmarrëveshjes, Kolegji vëren se ka pasur edhe një parashikim në këtë kontratë lidhur mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese për porosinë e apartamentit, sipas së cilës këstet do të paguheshin: përkatësisht 15.000 euro me hartimin e aktmarrëveshjes, 25.000 euro deri në muajin maj të vitit 2009, 15.000 euro deri në muajin dhjetor 2009, si dhe do të paguheshin 12.680 euro me dorëzimin dhe mbarimin e punimeve dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit deri më 31.05.2010.

Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjatë hetimit administrativ se mandati me nr. {\*\*\*} është lëshuar për lehtësi në këtë mënyrë nga shoqëria e ndërtimit, pasi në fakt kjo e fundit i ka lejuar subjektin, znj. Osmani, dhe bashkëshortin e saj të paguajnë me disa këste deri në fund të vitit 2009.

Si rezultat i rrethanave të konstatuara, cituar më sipër, shoqëria ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK sqaroi në informacionin e dërguar në Komision se *G. O. ka shlyer me pagesë në arkë 32.680 euro në datën 21.03.2009*, ndërsa subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të Komisionit, këtë shumë e ndan në katër këste përgjatë periudhës mars - dhjetor 2009.

**17.16** Vlerësimi i Kolegjit në këtë situatë lidhet me faktin se përcaktimi i kohës së shlyerjes së shumave, sipas aktmarrëveshjes së datës 02.02.2009, është një parashikim i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, duke përjashtuar këtu këstin e parë të paguar para lidhjes së aktmarrëveshjes, që do të ndodhte në të ardhmen. Në këtë kuptim, këto afate mund të konsiderohen si orientuese për palët nënshkruese dhe nuk kanë fuqinë e provueshmërisë së këtij rendi për shlyerjen e shumave, për sa kohë flitet për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen. Palët udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të ushtrojnë të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët, siç konfirmon edhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

---

<sup>6</sup> *Pagesë në arkë, 15.000 euro, datë 31.01.2009, fatura nr. {\*\*\*}; pagesë në arkë, 32.680 euro, datë 21.03.2009, fatura nr. {\*\*\*} (21.03.2009 - 31.12.2009); pagesë në arkë, 5.000 euro, datë 16.01.2010, fatura nr. {\*\*\*}; pagesë në arkë, 3.000 euro, datë 28.05.2010, fatura nr. {\*\*\*}; pagesë në arkë, 4.000 euro, datë 25.06.2010, fatura nr. {\*\*\*}; pagesë në arkë, 4.000 euro, datë 02.07.2011, fatura nr. {\*\*\*}.*



17.17 Kolegji konstaton se, pavarësisht mospërputhjeve mes të dhënave të nxjerra nga aktet më sipër, të gjitha faktet e konstatuara mbeten të lidhura me deklaratimet e palëve, subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Mospërputhja me rëndësi për çështjen lidhet me mandatpagesën nr. {\*\*\*}, sjellë bashkëngjitur përgjigjes së shoqërisë ndërtuese, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka paguar këstin prej 32.680 eurosh, më datë 21.03.2009. Kjo pagesë është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kohës dhe vlerës së saj dhe gjithashtu edhe nga vetë shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila në përgjigjet e dërguara në Komision, ka mbështetur me sqarimet e saj, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë fakt.

17.18 Trupi gjykues vëren se edhe në vendimin nr. 20/2019 (JR) të Kolegjit, që i përket bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, deklaratimet për mënyrën e shlyerjes së kësteve apo mandateve për pagimin e apartamentit me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, gjatë procesit të saj të rivlerësimit, janë të njëjta dhe përputhen plotësisht, çka e bën të besueshme situatën faktike të kryerjes së pagesave, e cila është e ndryshme nga ato të paraqitura nga shoqëria e ndërtimit, gjë e cila mbështet deklaratimin e subjektit të rivlerësimit të bërë në deklaratën periodike të vitit 2009.

17.19 Kolegji çmon se në mungesë të dokumentacionit provues ligjor, që do të provonte në mënyrë bindëse vlerën dhe kohën e pagimit të shumës prej 47.680 eurosh përgjatë vitit 2009, do të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën periodike të vitit 2009, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.* Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, Kolegji konsideron se pagesa e vlerës prej 47.680 eurosh, e kryer në vitin 2009, është realizuar përgjatë këtij viti, deri në datën 31.12.2009, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.

17.20 Kolegji kreu analizën financiare për vitin 2009 për subjektin e rivlerësimit, për të verifikuar nëse kishte mundësi financiare që të përballonte me burime të ligjshme pagimin e shumës prej 47.680 eurosh në vitin 2009. Në përfundim, Kolegji konstatoi se nga analiza financiare e kryer për verifikimin e mundësisë pague, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të krijonte këtë shumë dhe, si rrjedhojë, të paguante vlerën prej 47.680 eurosh, pasi rezultoi nga kjo analizë me diferencë pozitive prej 161.967 lekësh. Si rrjedhojë, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit përballonte me burime të ligjshme pagimin e kësaj shume, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar për mundësinë e krijimit të burimeve të ligjshme për pagesën e kësaj shume në vitin 2009.

18. ***Lidhur me huan e marrë ndaj z. A. Q.,*** si burim i blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: *Kontratë huaje pa afat, në formë shkresore, me qellim blerje të një apartamenti banimi, e lidhur në datë 21.08.2009, për marrjen e një huaje në shumën 20.000 (njëzet mijë) euro, me një interes vjetor prej 5% (pesë për qind).* Në këtë deklaratë (DIPP-në e vitit 2009), subjekti i

rivlerësimit e ka deklaruar këtë marrëdhënie si në rubrikën në të cilën përshkruhet pasuria dhe burimet e saj, si një prej burimeve të krijimit të pasurisë apartament, ashtu edhe në rubrikën në të cilën deklarohen detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit ka paraqitur përpara Komisionit, së bashku me përgjigjet e datës 29.04.2018, dokumentin shkresor të titulluar “Kontratë huaje”, e cila është lidhur ndërmjet shtetasve A. Q. (huadhënës) dhe G. O. (huamarrës), më datë 21.08.2009, e nënshkruar vetëm nga palët, ku si të pranishëm kanë firmosur edhe Marinela Osmani (Nuni) e P. Q. Kjo marrëveshje mes palëve është titulluar kontratë huaje dhe është lidhur vetëm me dakordësinë e tyre, pa e formalizuar para noterit.

**18.1** Kolegji vëren se objekt i kësaj kontrate është dhënia e një shume hua, prej 20.000 eurosh, kundrejt një interesi vjetor prej 5%. Në të është parashikuar shlyerja në muajin gusht të çdo viti dhe përfundimi i saj jo më parë se pesë vjet. Shuma e marrë hua është parashikuar se do të përdoret nga huamarrësi për blerjen e një apartamenti banimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo shumë është sjellë dorazi nga z. Q., duke qenë se ky i fundit jeton në Itali. Kolegji konstaton se marrëdhënia e huas mes subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur, z. A. Q., ka qenë e deklaruar si e tillë që në deklaratën periodike të vitit 2009. Në këtë deklaratë, subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie si në rubrikën në të cilën përshkruhet pasuria dhe burimet e saj, si një prej burimeve të krijimit të pasurisë apartament, ashtu edhe në rubrikën në të cilën deklarohen detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë. Në këtë të fundit, subjekti ka deklaruar jo vetëm ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, por edhe dokumentin me të cilin e provon, i cili, sipas këtij deklarimi, është një kontratë huaje në formë shkresore, e lidhur në datën 21.08.2009, për shumën 20.000 euro. Në deklaratimet periodike të viteve të mëpasshme, 2011, 2012 e 2013, subjekti ka deklaruar shlyerjen e saj sipas kësteve përkatëse.

Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në pyetëtorin nr. 1 të Komisionit, ka sqaruar se me bashkëshortin e saj, kanë shlyer përkatësisht vit pas viti këto vlera nga huaja e marrë nga z. Q. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë shlyer: 7.000 euro në vitin 2011, 5.000 euro në dhjetor të vitit 2012, ndërsa në dhjetor të vitit 2013, kanë shlyer 8.000 euro, duke konfirmuar kështu deklaratimet periodike përkatëse ku janë deklaruar këto shlyerje të huas.

**18.2** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), në deklaratimet e saj në pyetësorët e Komisionit, ka deklaruar në vijimësi, ashtu sikurse ka arsyetuar Kolegji në vendimin e bashkëshortit të saj, z. G. O. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar ligjshmërinë e aktit kontraktor, parashikimet kontraktore lidhur me afatin e shlyerjes së huas, si dhe mënyrën e sjelljes së kësaj shume nga Italia. Subjekti ka shpjeguar se sjellja dorazi, ndër vite, e shumës prej 20.000 eurosh, nga personi tjetër i lidhur, nuk mund të vërë në dyshim këtë deklaram, në kushtet kur të vepruarit në këtë mënyrë është e lejuar dhe mund të konfirmohet nga udhëtimet e kryera prej tij në territorin e Republikës së Shqipërisë. Legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk ka parashikuar asnjëherë ndonjë detyrim ligjor për kalimin e shumave në rrugë bankare midis dy individëve. Gjithashtu, një indicie tjetër, sipas subjektit të

rivlerësimit, që duhej të merrej në konsideratë nga Komisioni, në favor të subjektit të rivlerësimit, është fakti që kjo hua, prej vitit 2013, është e shlyer, fakt i cili hedh poshtë çdo dyshim mbi vërtetësinë e saj. Kjo shumë, sipas subjektit, znj. Osmani, është rrjedhojë e kursimeve vjetore të saj, si dhe këto dërgesa nuk e kanë kaluar asnjëherë vlerën prej 1.000.000 lekësh.

**18.3** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), nuk ka pasur mundësi financiare gjatë viteve 2011 - 2013, për të shlyer huan, të shtojë kursimet vit pas viti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar për këto çështje dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova. Komisioni, për sa më sipër, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen *cash*, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**18.4** Trupi gjykues vëren se për të verifikuar mundësinë e shlyerjes së këtyre vlerave vit pas viti, u krye analiza financiare në Kolegj, nga e cila rezultoi se për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të përballojë shlyerjen e huas, shpenzimet e jetesës dhe gjithashtu edhe krijimin e kursimeve për diferencën negative në shumën 566.902 lekë.

Si pjesë e analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, nga studimi i deklaratave të pasurisë, si dhe i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit nëpër pyetësorë, rezulton se ky i fundit ka deklaruar gjendjen e *cash*-it në banesë në këtë mënyrë:

Në DIPP 2009, deklaratë në të cilën subjekti deklaron për herë të parë edhe për bashkëshortin, gjendja e *cash*-it deklarohet: *Cash në shumën 15.000 euro (të mbetura nga kontrata e huas). Kursime nga paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës të miat dhe të bashkëshortit, në cash për vitin 2009, në shumën 1.400.000 lekë.*

*Të kursyera, e ardhura në formën e dietave nga një vizite studimore në Gjermani e bashkëshortit për periudhën 14.06.2009 - 20.06.2006, në shumën neto të 500 eurove.*

Në rubrikën e deklaramit të interesave privatë të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. O. deklaron: *Kursime cash në vite, deri në vitin 2009, para lidhjes së martesës, në shumën 2.400.000 lekë, nga marrëdhëniet e punës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës e Tiranë.*

Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Cash në shumën 3500 euro (të mbetura nga kontrata e huas prej 20.000 eurosh).*

*Kursime nga paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës të miat dhe të bashkëshortit, në cash për vitin 2010, në shumën 950.000 lekë.*

*Të ardhura nga shitja e automjetit në shumën 240.000 lekë.*

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Ndryshime të interesave privatë dhe pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar:

*1. Në zbatim të aktmarrëveshjes nr. {\*\*\*} rep., datë 02.02.2009, për blerjen e apartamentit, për vitin 2011, është shlyer detyrimi në shumën prej 4.000 eurosh dhe kanë mbetur pa shlyer dhe 4000 euro për shkak të mosregjistrimit në ZVRPP Tiranë. Burimi i pagesës deri në 31.12.2011, është pjesë e mbetur e huas dhe nga kursimet.*

*2. Kursime nga paga nga marrëdhëniet e punës të miat dhe të bashkëshortit dhe shpërblime të tjera në cash për vitin 2011, në shumën 500.000 lekë.*

**18.5** Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka përdorur si burim për blerjen e apartamentit të gjitha kursimet e tij deri më 31.12.2009 dhe vlera e mbetur në banesë në datën 31.12.2009, është vetëm vlera 15.000 euro, nga huaja e marrë nga z. A. Q. në korrik 2009, në vlerën 20.000 euro, të cilën e ka përdorur për shlyerjen e apartamentit me këstet si vijojnë: i) pagesë kësti apartamenti me burim nga huaja, shlyer gjatë vitit 2009, në vlerën 5.000 euro; ii) pagesë kësti apartamenti me burim nga huaja, shlyer gjatë vitit 2010, në vlerën 11.500 euro; iii) pagesë kësti apartamenti me burim nga huaja, shlyer gjatë vitit 2011, në vlerën 3.500 euro.

**18.6** Nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit, Kolegjit i rezultoi se nga diferenca mes të gjitha të ardhurave të subjektit dhe shpenzimeve të kryera për pagesën e kësteve të apartamentit, shpenzimeve të jetesës dhe gjithashtu edhe për shpenzime TIMS, subjektit duhet t'i tepronin në banesë në datën 31.12.2009, 15.000 euro, shumë të cilën subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si kursim, kur në fakt ishte gjendja e mbetur pa shlyer këstet e apartamentit me burim nga huaja që i mori shtetasit A. Q. për shlyerjen e pagesave të apartamentit të banimit. Si rrjedhojë, Kolegji e konsideroi këtë shumë si pjesë të huas së marrë për shlyerjen e apartamentit dhe jo si kursim nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

**18.7** Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, trupi gjykues vëren se gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën e kësteve prej 12.000 eurosh për apartamentin e blerë në vitin 2009, me burim të deklaruar si pjesë e huas dhe kursimi prej 500 eurosh. Gjithashtu, për këtë vit, subjekti, znj. Osmani, ka deklaruar se ka në banesë 3.500 euro të mbetura nga kontrata e huas, 950.000 lekë kursime nga paga e saj dhe e bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në shumën 240.000 lekë.

Në analizën financiare është kryer përlllogaritja duke mbartur nga viti 2009, shumën prej 15.000 eurosh, janë zbritur pagesat e këstit të apartamentit në shumën 12.000 euro dhe janë shtuar vlerat e kursimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën përkatëse. Nga analiza e vitit 2010, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për ta përballuar pagesën e këstit prej 12.000 eurosh, pagesën e shpenzimeve vjetore dhe gjithashtu mundësi të krijimit të kursimit të deklaruar në shumën 3.500 euro, 950.000 lekë dhe 240.000 lekë.

**18.8** Për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka kryer pagesën e këstit për këtë vit në shumën 4.000 euro, me burim nga pjesa e mbetur e huas dhe kursimet dhe gjithashtu ka deklaruar se ka kursyer nga paga e saj dhe e bashkëshortit, vlerën 500.000 lekë. Në këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka kryer shlyerjen e vlerës 7.000 euro nga huaja e marrë shtetasit A. Q. në vitin 2009, por pa deklaruar burim apo pa deklaruar nëse kjo pagesë është kryer nga pakësimi i kursimeve të

viteve më parë. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se: *Kursimi në vitin 2011 ishte konceptuar dhe deklaruar nga ana ime, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve për jetesë. Detyrimi i shlyer nga huaja, prej 7.000 eurosh, nuk është zbritur dhe nuk është deklaruar si pakësim. Në të njëjtën mënyrë është vepruar dhe ne dy vitet e tjera, në të cilat është shlyer huaja*". Lidhur me qëndrimin e subjektit për gjendjen *cash*, duke mbajtur në konsideratë deklaramet periodike vjetore të subjektit, deklaramet gjatë hetimit administrativ, pretendimet e subjektit në prapësime, Kolegji ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me deklaramet e kryera gjatë viteve 2009 – 2011. Për këtë periudhë, në deklaramet e kursimeve në gjendjen *cash*, është përfshirë edhe gjendja likuiditet në banka në fund të çdo viti, deri në vitin 2011. Ndërsa, për vitet pas kësaj periudhe, Kolegji për kryerjen e përllogaritjeve u ka qëndruar deklarameteve periodike të subjektit, ku shumat e deklaruara janë konsideruar si shtesa, për sa kohë nuk është përcaktuar ndonjë destinacion i përdorimit të gjendjes *cash* apo në funksion të shlyerjes së ndonjë detyrimi.

**18.9** Kolegji vëren se për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit dhe gjithashtu sipas DIPP-së së vitit 2012, ka shlyer në dhjetor të këtij viti vlerën 5.000 euro nga huaja e marrë për blerjen e pasurisë apartament banimi.

Në rubrikën e ndryshimeve të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *Kursime nga paga nga marrëdhëniet e punës të miat dhe të bashkëshortit dhe shpërblime të tjera në cash për vitin 2012, në shumën 1.000.000 lekë.*

Nga analiza financiare e kryer për këtë vit, nga diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2012, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të përballuar shpenzimet, pagesën e huas dhe gjithashtu krijimin e kursimeve.

**18.10** Për vitin 2013, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit dhe gjithashtu në deklaramin periodik të pasurisë për vitin 2013, ka shlyer në dhjetor të këtij viti vlerën 8.000 euro nga huaja e marrë për blerjen e pasurisë apartament. Në rubrikën e ndryshimeve të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, në DIPP 2013, ka deklaruar: *Kursime nga paga nga marrëdhëniet e punës të miat dhe të bashkëshortit dhe shpërblimet e tjera në cash për vitin 2013, në shumën 1.450.000 lekë.*

**18.11** Kolegji vëren se, bazuar në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, rezultoi se nuk ka pasur mundësi të kryejë shlyerjen e huas, përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe gjithashtu edhe krijimin e kursimeve në vitin 2011, për vlerën 566.902 lekë. Nga diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të përballuar shpenzimet, pagesën e huas dhe gjithashtu krijimin e kursimeve për diferencën negative në vlerën 1.126.384 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit për vitet 2011 dhe 2013, ka pasur mungesë të burimeve financiare te ligjshme për të justifikuar pasurinë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Diferenca negative për vitet 2011 dhe 2013, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, analizuar në Kolegj me vendimin nr. 20/2019, ka rezultuar në shumën 586.542 lekë në vitin 2011 dhe 1.173.955 lekë në vitin 2013.

**18.12** Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Kolegji, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurisë likuiditet, në formën e gjendjes *cash*, dhe të shpenzimeve për jetesë e shlyerjen e detyrimit ndaj personit tjetër të lidhur, në vitet 2011 e 2013, mungesë e cila konsiston në shumën 1.693.286 lekë dhe rezulton e njëjtë me atë të konkluduar nga Kolegji në vendimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. G. O., duke u gjendur për pasojë përpara parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Kjo pamjaftueshmëri financiare rezulton e njëjtë për të dyja subjektet dhe vjen si rezultat i shpenzimeve dhe i deklarimit të kursimeve të përbashkëta, pamjaftueshmëri për të cilën është aplikuar masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për personin e lidhur, bashkëshortin e subjektit, sipas vendimit nr. 20/2019 (JR).

19. Kolegji çmon se, duke iu referuar rezultateve të analizave financiare, të cilat konkludohen të njëjta si në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, ashtu edhe në procesin e rivlerësimit të bashkëshortit të saj, z. G. O., në të cilat rezulton me diferencë negative analiza e vitit 2011 dhe ajo e vitit 2013, janë rrethana objektive të cilat çojnë në konkluzionin se deklaratimet e këtyre dy subjekteve të rivlerësimit janë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën sa u përket deklaratave periodike vjetore dhe asaj *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, duke mos evidentuar kontradiksione në këto deklarata, por gjenden në përputhshmëri me njëra-tjetrën, si dhe të mbështetura në dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit lidhur me procesin e tyre të rivlerësimit.

**19.1** Kolegji konstatoi gjithashtu se diferenca negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj për subjektin rivlerësimit, cituar në paragrafin 18.11 më sipër, rezulton se është krijuar e afektuar nga veprime financiare të kryera në vite, të shtrirë në kohë, veprimet e të cilave kanë krijuar diferenca negative në dy vite. Duke vlerësuar këtu shtrirjen e periudhës në të cilën kryhet procesi i rivlerësimit, nuk rezulton që kjo diferencë negative të ketë qenë e akumuluar në një vit të vetëm. Për më tepër, kjo diferencë negative përkon me dy ndër tri vitet që subjekti i rivlerësimit ka shlyer huan e marrë nga A. Q., periudhë në të cilën subjekti, znj. Osmani, dhe bashkëshorti i saj duhet t’u përmbaheshin kushteve të marrëveshjes për shlyerjen e huas që shërbeu për blerjen e apartamentit me sip. 72 m<sup>2</sup>, konsideruar si periudhë e ngarkuar me shpenzime, nga ana tjetër duke vënë theksin se kjo pamjaftueshmëri nuk lidhet me një moment specifik të krijimit të ndonjë pasurie.

**19.2** Kolegji vëren se pasuria e cila është marrë në shqyrtim nga Kolegji dhe Komisioni për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të, ka qenë objekt verifikimi e kontrolli në kuptim të procesit të rivlerësimit pikërisht për shkak se ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament, që është sot në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Si e tillë, kjo pasuri (apartamenti 72 m<sup>2</sup>) është pasuria e vetme e paluajtshme e krijuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani,

dhe bashkëshorti i saj, e cila nuk është deklaruar as në deklaratën *vetting*, meqenëse subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë pasuri në vitin 2016 dhe paratë e përfituara nga ky veprim juridik, kanë shërbyer si një prej burimeve për blerjen e apartamentit në të cilin subjekti dhe personi i lidhur me të banon sot, si rrjedhojë rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, me kursimet e deklaruara ndër vite dhe huan e marrë z. A. Q., kanë krijuar vetëm një pasuri të paluajtshme.

**19.3** Trupi gjykues çmoi se nga sa rezultoi e provuar, nga tërësia e fakteve dhe e rrethanave të analizuar në Kolegj në kuadër të vlerësimit të pasurisë, nuk u konstatuan indicie apo dyshime gjatë kontrollit në ILDKPKI, apo Komision, si dhe nuk është pretenduar as nga Komisioneri Publik në Kolegj, që gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, znj. Marinela Osmani (Nuni), të kenë rezultuar problematika apo të jenë krijuar dyshime për deklarim të rremë, fshehje pasurie apo të jetë gjendur në kushtet e konfliktit të interesit. Parashikimi kushtetues i nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës e lidh gjithmonë defektin në deklarime me përpjekje për të fshehur apo mos deklaruar saktë, që do të thotë se duhet të ekzistojë një qëllim për të defektuar deklarimin.

20. Referuar parashtimeve të dorëzuara në Kolegj më datë 19.04.2022, subjekti i rivlerësimit argumentoi se në vijim të paprekshmërisë së vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjithashtu, subjekti argumenton se Kolegji në vendimin nr. 20/2019 (JR), që i përket z. G. O., bashkëshortit të saj, ka përcaktuar shprehimisht një hetim të kufizuar administrativ për Komisionin vetëm mbi provat që i përkasin çështjes së saj, pra që kanë lidhje me pasuri të pahetuara dhe të disponuara veçmas nëse do të kishte, si dhe mbi dy kriteret e tjera të vlerësimit.

**20.1** Kolegji vëren se referuar nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave të këtij korpusi ligjor nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kriteret vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe të personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016. Që këtu vlen të theksohet se secili subjekt rivlerësimi duhet të rivlerësohet në mënyrë të pavarur jo vetëm në kriteret e figurës dhe aftësisë profesionale, të cilat janë thellësisht individuale, por edhe në kriterin e pasurisë, si një kriter që përfshin edhe persona të tjerë në marrëdhënie pronësie, persona të lidhur apo të tjerë të lidhur qofshin ata.

**20.2** Gjithashtu, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, arrihet në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, ose mund të rezultojë të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj, apo që pasuria të mos jetë ekskluzive në emër të subjektit të rivlerësimit, por të jetë në bashkëpronësi. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimin të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

**20.3** Kolegji vëren se nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjeve të paketës për reformën në drejtësi, vlerësohet se standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e pasurive të magjistratëve, kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruara, qofshin këto të krijuara para apo pas emërimit në detyrë të magjistratit, për sa kohë, referuar dispozitave të ligjit për statusin e magjistratit, verifikimit të plotë të pasurive, sipas të njëjtave standarde të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm për kontrollin dhe deklarimin e tyre, i nënshtrohen edhe kandidatët për t'u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të diplomuarit prej kësaj shkolle para emërimit të tyre si magjistratë gjyqtarë/prokurorë. Duke u nisur nga ky parashikim ligjor që shkon përtej detyrës së magjistratit, edhe në rastin konkret ku pasuria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është vlerësuar nga Komisioni dhe Kolegji, ky duhet të jetë një proces krejtësisht i pavarur për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), në drejtim të qëllimit të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se në rastin konkret z. G. O. dhe subjekti i rivlerësimit janë bashkëshortë dhe kanë pasuri të përbashkët, e cila është vlerësuar më parë, në rastin e bashkëshortit, vendimi i Kolegjit për vlerësimin e këtij të fundit nuk përbën gjë të gjykuar për Kolegjin. Kjo situatë duhet të shihet edhe në raport me personin e lidhur dhe efektet e rezultateve të vlerësimit të pasurisë në këndvështrimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili në pikën 1 të tij parashikon se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

**20.4** Kolegji sjell në vëmendje vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, të Gjykatës së Lartë, ku Kolegjet e Bashkuara kanë arsyetuar se në vendimet e saj Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) citon shprehimisht pjesët e Raportit Shpjegues të Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale<sup>7</sup> duke konfirmuar se një vendim

---

<sup>7</sup> Raport Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, CETS No. 70, bërë në Hagë më datë 28.05.1970, ratifikuar me ligjin nr. 9068, datë 15.05.2003, “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane



merr statusin e gjësë së gjykuar (*res judicata*) nëse palët: i) kanë shteruar ankimet në rrugë të zakonshme; ose ii) kanë humbur afatet për të paraqitur ankim kundër vendimit të dënimit, duke marrë kështu vendimi formë të përvokueshme. Në këtë vendim citohet se, GjEDNj-ja në disa vendime kundër Shqipërisë ka vendosur shprehimisht se, edhe nëse vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, për sa kohë ekziston mundësia për ta apeluar në një gjykatë të një instance më të lartë, siç është edhe Gjykata e Lartë, atëherë ai vendim [i gjykatës së apelit] nuk do të konsiderohet si *res judicata*.

**20.5** Gjykata e Lartë, në vendimin nr. 58, datë 22.01.2013, të Kolegjit Civil, vlerëson të sqarojë se cili është parimi i gjësë së gjykuar sipas legjislacionit shqiptar dhe se kur mund të zbatohet ai. Në referim të nenit 451/a të K. Pr. Civile: *Vendimi që ka marrë formë të prerë, ka fuqi vetëm për çfarë është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak*. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Me marrjen e formës së prerë, vendimi fiton fuqinë e “gjësë së gjykuar” për konfliktin që ka zgjidhur, dhe përcakton në mënyrë përfundimtare dhe të pandryshueshme marrëdhëniet juridike civile midis palëve duke përjashtuar mundësinë e ndonjë konflikti gjyqësor tjetër midis po atyre palëve për të njëjtën çështje. Në analizë të nenit 451/a të K.Pr.Civile, rezulton se elementet e gjësë së gjykuar janë: *të njëjtat palë* (identiteti i palëve); *i njëjti objekt* (identiteti i objektit); *i njëjti shkak* (identiteti i shkakut).

**20.6** Kolegji vlerëson se, si në rastin konkret, qenia e dy subjekteve të rivlerësimit njëkohësisht edhe bashkëshortë, si dhe pasja e pasurive të përbashkëta në objekt të shqyrtimit në proceset e tyre të rivlerësimit, nuk afekton procesin e bashkëshortit që rivlerësohet i dyti në kohë dhe nuk përbën gjë të gjykuar edhe pse kanë pasuri të përbashkëta, pasi subjektet e rivlerësimit që janë subjekt i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtën e një procesi rivlerësimi të pavarur, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së tyre dhe konsiderohen procese me palë të ndryshme e, për rrjedhojë, nuk përbëjnë gjë të gjykuar.

21. Kolegji vëren se në diskutimet përfundimtare të datës 24.05.2022, Komisioneri Publik parashtroi zbatimin e parimit të proporcionalitetit, sipas disa standardeve objektive të vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, të cilat zbatohen rast pas rasti, si: (i) Masa disiplinore e shkarkimit të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. (ii) Gjykimi duhet bërë në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit dhe që rëndësia e shkeljes të jetë e tillë që të lejojë ose jo zbatimin e këtij parimi. (iii) Dhënia e një mase disiplinore, e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara. Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në rastin konkret, parë nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe vlerësimit tërësor të procedurës së

---

*për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale”. Cituar gjithashtu nga Raporti Shpjegues i Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.*

rivlerësimit, ku nuk janë konstatuar problematika në kontrollin e kriterit të figurës dhe kriterit të aftësive profesionale, çon në përfundimin se rëndesa e kësaj shkeljeje për të cilën është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për personin e lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është e tillë që lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

**21.1** Subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, në fjalën e saj në diskutimet përfundimtare, ka parashtruar se Komisioni ka analizuar konkluzionin e tij nën dritën e parimit të proporcionalitetit, duke u bazuar në orientimin dhe praktikën e evolucionit të vetë Komisionit, si dhe Kolegjit. Ky qëndrim, sipas subjektit të rivlerësimit, është në përputhje të plotë me konkluzionet e dhëna nga GjEDNJ-ja në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Duke pasur në konsideratë të gjitha rrethanat faktike dhe juridike në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, parashtron se Komisioni ka arritur të balancojë drejt interesin e publikut dhe të drejtat e saj si subjekt rivlerësi, duke garantuar këto të drejta sipas nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Subjekti i rivlerësimit parashtron gjithashtu se marrja e masës disiplinore përbën një ndërhyrje shumë të rëndë dhe joproporcionale në të drejtën e saj për jetë private dhe familjare. Diferenca negative në vlerën 1.785.365 lekë, nuk mund të konsiderohet si arsye e mjaftueshme dhe legjitime për të justifikuar marrjen e masave administrative ndaj dy magjistratëve të së njëjtës familje.

**21.2** Në përfundim të seancës gjyqësore publike së diskutimeve përfundimtare, Komisioneri Publik i kërkoi trupit gjykues lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), duke arsyetuar (Kolegji) në vendimin e tij dhe orientimin që duhet të ketë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mbi zbatimin e parimeve udhëzuese për raste të ngjashme, për subjektet e rivlerësimit që janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësi.

**21.3** Subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, në fjalën e saj të diskutimeve përfundimtare për çështjen e saj të rivlerësimit, kërkoi nga trupi gjykues: Lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- 22.** Kolegji vëren se nga tërësia e shqyrtimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në këto rrethana objektive: (i) Deklarimet e subjektit dhe personit të lidhur me të, janë në harmoni dhe nuk kanë kontradikta ndërmjet tyre<sup>8</sup>. (ii) Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar është e njëjtë për të dyja subjektet dhe vjen si rezultat i shpenzimeve dhe i deklarimit të kursimeve të përbashkëta, pamjaftueshmëri për të cilën është aplikuar masa disiplinore e shkarkimit për personin e lidhur/bashkëshorti sipas vendimit (JR) nr. 20/2019<sup>9</sup>. (iii) Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar është e shtrirë në kohë dhe nuk lidhet me një moment specifik të krijimit të ndonjë pasurie<sup>10</sup>. (iv) Me kursimet e deklaruara ndër vite dhe

<sup>8</sup> Lidhur me këtë rrethanë të konkluduar nga Kolegji, referohuni në paragrafët më sipër me nr. 17.1; 17.2; 17.9; 17.10; 17.11; 18; 18.4; 18.9.

<sup>9</sup> Lidhur me këtë rrethanë të konkluduar nga Kolegji, referohuni në paragrafët më sipër me nr. 18.11; 18.12 dhe 19.

<sup>10</sup> Lidhur me këtë rrethanë, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri në vitet 2011 dhe 2013, që sipas analizës në paragrafët nr. 18.11 dhe 19.1 më sipër, rezulton se kjo pamjaftueshmëri është krijuar e afektuar nga veprime financiare të kryera në vite.

huan, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë krijuar një pasuri të paluajtshme<sup>11</sup>. (v) Nuk është konstatuar deklarim i rremë, fshehje pasurie apo gjendja në kushtet e konfliktit të interesit nga subjekti i rivlerësimit<sup>12</sup>.

23. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes së gjykuar në seancë publike për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), pasi dëgjoji edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

**23.1** Kolegji vlerësoi se vendimi nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019, i dhënë në çështjen që i përket bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i cili ka qenë subjekt i rivlerësimit kalimtar, nuk konsiderohet se përbën gjë të gjykuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), duke rikonfirmuar konkluzionin e paragrafit 78 të vendimit të sipërcituar. Në atë vendim, Kolegji ka arsyetuar: “Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe sqaron se ky vendim në asnjë mënyrë nuk paragjykon të drejtën e saj për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk do të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, të cilin bashkëshortja e subjektit ka të drejtë ta ketë, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së saj dhe në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit”. Për sa i përket kërkesës së Komisionerit Publik për orientime të Komisionit për situata hipotetike që mund të rezultojnë në të ardhmen në çështje ku subjekte të rivlerësimit janë magjistratë bashkëshortë, por që nuk lidhen drejtpërdrejt me situatën specifike faktike dhe ligjore të vendimit objekt shqyrtimi, konsiderohet nga trupi gjykues se tejkalon të drejtat dhe detyrat e Kolegjit të përcaktuara në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**23.2** Bazuar në rrethanat specifike dhe objektive të çështjes në shqyrtim, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, për mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pasurinë *cash*, si dhe shlyerjen e huas për vitet 2011 dhe 2013, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit nr. 344, datë 11.02.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve dhe provave të rezultuara gjatë hetimit administrativ e në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky vlerësim i Kolegjit mbajti në konsideratë edhe arsyetimin e ndryshëm të Komisionerit Publik për këtë fakt, i cili në përfundim të gjykimit të çështjes, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

---

<sup>11</sup> Lidhur me këtë rrethanë të konstatuar nga Kolegji, që sipas analizës në paragrafët 16.3, 17.6 dhe 19.2 më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, me kursimet e deklaruara ndër vite dhe huan e marrë z. A. Q., kanë krijuar vetëm një pasuri të paluajtshme.

<sup>12</sup> Për këtë rrethanë të konstatuar nga Kolegji, referohuni në paragrafët më sipër me nr. 2.1, 8.2, 19.3.

24. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
25. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.05.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, jemi dakord me zgjidhjen e çështjes me vendimin nr. 17, datë 27.05.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 344, datë 11.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), por kemi mendim paralel me shumicën e trupit gjykues lidhur me arsyet e marrjes së këtij vendimi, si më poshtë.
2. Jemi dakord dhe kemi mendim të njëjtë me anëtarët e tjerë të trupit gjykues për qëndrimin e mbajtur në vendim lidhur me kërkimin e Komisionerit Publik që, në kuadër të kësaj çështjeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit të jepte orientime të përgjithshme për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit mbi zbatimin e parimeve udhëzuese që lidhen me objektivitetin dhe proporcionalitetin për raste të ngjashme, ku subjektet e rivlerësimit janë persona të lidhur me subjekte të tjera rivlerësimi, por nuk kemi të njëjtin mendim për arsyet specifike të kësaj çështjeje, për të cilat vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi u la në fuqi.
3. Për ne, ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, lënia në fuqi e vendimit objekt shqyrtimi nuk bazohet në analizën e fakteve juridike të natyrës materiale dhe në mënyrën e zbatimit të ligjit material për këto fakte mbi bazën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, por bazohet dhe kufizohet vetëm mbi fakte juridike të natyrës procedurale që lidhen me kërkimin përfundimtar të Komisionerit Publik.
4. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në seancë gjyqësore publike, në bisedimet përfundimtare për çështjen, Komisioneri Publik i kërkoi trupit gjykues lënien në fuqi të vendimit të Komisionit për të cilin kishte ushtruar të drejtën e kundërshtimit nëpërmjet ankimit të paraqitur në Kolegj. Në këto kushte, Komisioneri Publik, bazuar në të drejtën e tij për të disponuar mbi objektin e ankimit në çdo fazë të gjykimit të çështjes në Kolegj, e kufizoi objektin e ankimit vetëm për pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit të Komisionit, duke deklaruar se është dakord me pjesën urdhëruese të tij.
5. Në vlerësimin tonë, analizimi që Komisioneri Publik i bëri në bisedimet përfundimtare të çështjes situatës faktike dhe ligjore të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), është në përputhje të plotë me të drejtat dhe detyrat e tij procedurale. Sipas vlerësimit tonë, pushteti diskrecionar i Komisionerit Publik për ligj vlerësimin nën këtë dritë të qëndrimeve që ai mban për zgjidhjen e çështjes, por nuk obligon gjykatën të mbajë një qëndrim mbi to. Ky qëndrim – i cili përsëri do të duhej të artikulohej në kontekstin e kufijve diskrecionarë të gjykatës e në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për sa kohë që institucioni publik i ngarkuar posaçërisht me detyrën e vlerësimit, edhe në këtë kontekst, të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në mbrojtje të interesit publik, e ka kryer këtë proces në mënyrë të plotë – u çmua i panevojshëm.

6. Në këto kushte, e vlerësuam të panevojshme të mbajmë një qëndrim mbi arsyet që Komisionieri ka vlerësuar për të arritur në qëndrimin e tij përfundimtar dhe, si rrjedhojë, e kufizuam arsyetimin tonë për votimin në favor të lënies në fuqi të vendimit nr. 344, datë 11.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vetëm në një qëndrim me natyrë procedurale.
7. Në kushtet kur vetë ankuesi kërkoi lënien në fuqi të pjesës urdhëruese të vendimit të Komisionit, me të cilin është vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani (Nuni), mbi të njëjtën situatë faktike dhe ligjore, i vetmi vendim që mund të merrte Kolegji, ishte lënia në fuqi e vendimit objekt shqyrtimi.

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*